



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH Nr. 29/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z.Goran Milenkovič - Kryetar, z.Ekrem Salihu - Referues, z.Blerim Dina - Anëtar, z.Nuhi Paçarizi-Anëtar, z.Tefik Sylejmani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE ankues në Konzercium: “FAM (Förderanlagen Magdeburg) - Gjermani & N.T.SH EKOINVEST” - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës “Riparimi mekanik dhe elektrik i stacionit veprues të shiritit transportues me gjatësi 1800 mm”, me nr prok: “16/164/511”, iniciuar nga autoriteti kontraktues /Korporata Energjetike e Kosovës/, më datën 07.03.2017 mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet**, pjesërisht si e bazuar ankesa e OE “FAM (Förderanlagen Magdeburg) - Gjermani & N.T.SH EKOINVEST” - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Riparimi mekanik dhe elektrik i stacionit veprues të shiritit transportues me gjatësi 1800 mm”, me nr prok: “16/164/511”, iniciuar nga autoriteti kontraktues /Korporata Energjetike e Kosovës/.
- II. **Vërtetohet**, vendimi për dhënie të kontratës i AK-së /Korporata Energjetike e Kosovës/, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Riparimi mekanik dhe elektrik i stacionit veprues të shiritit transportues me gjatësi 1800 mm”, me nr prok: “16/164/511”.
- III. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh, duhet ta informojë me shkrim Panelin shqyrtues, për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe palët tjera në procedurë.

- IV. Operatorit ekonomik ankues OE "FAM (Förderanlagen Magdeburg) - Gjermani & N.T.SH EKOINVEST" - Prishtinë, i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumë e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, pasi që ankesa është aprovuar pjesërisht si e bazuar.
- V. Obligohen operatorë ekonomik ankues që konform nenit 36 pika 5 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:27.04.2016.

Hapja e ofertave është bërë me dt: 09. 06. 2016, ku kanë marr pjesë gjashtë (6) operatorë ekonomik.

Letra standarde për tenderuesin e pasuksesshëm është bërë me datën 16.11.2016.

Njoftimi për dhënie të kontratës është bërë me dt: 15.11.2017, e ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik "SOLID Company Shpk"-Prishtinë.

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës, operatori ekonomik "FAM (Förderanlagen Magdeburg) - Gjermani & N.T.SH EKOINVEST"- Prishtinë, me dt:21.11.2016, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt:18.01.2017, autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "FAM (Förderanlagen Magdeburg) - Gjermani & N.T.SH EKOINVEST"- Prishtinë.

Operatorët ekonomik "FAM (Förderanlagen Magdeburg) - Gjermani & N.T.SH EKOINVEST" - Prishtinë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, më 27 janar 2017 me nr. 29/17, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Riparimi mekanik dhe elektrik i stacionit veprues të shiritit transportues me gjatësi 1800 mm", me nr prok: "16/164/511", duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 28 i LPP-së Specifikimet teknike
- Neni 59 i LPP-së –Ekzaminimi, vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 60 i LPP-së- Kriteret për Dhënien e Kontratës
- Neni 40 i UOPP-së-

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së, ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues përmes raportit të datës 28 shkurt 2017, ka rekomanduar panelin shqyrtues që të aprovojë si pjesërisht të bazuar ankesën e OE “FAM (Förderanlagen Magdeburg) - Gjermani & N.T.SH EKOINVEST” – Prishtinë, për këtë aktivitet të prokurimit me titull “Riparimi mekanik dhe elektrik i stacionit veprues të shiritit transportues me gjatësi 1800 mm”, me nr prok: “16/164/511” i iniciuar nga autoriteti kontraktues KEK.

Operatori ekonomik ankues “FAM (Förderanlagen Magdeburg) - Gjermani & N.T.SH EKOINVEST” – Prishtinë, me datë: 02 mars 2017, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 07.03.2017, ku kanë qenë prezent anëtarët e panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues, përfaqësuesit e palëve në procedurë, vëzhgues nga OJQ “DPlus”, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues “FAM & Ekoinvest” ka deklaruar: “Ashtu siç përmendi z.Saliu për këtë aktivitet të prokurimit kemi qenë dy OE të përgjegjshëm. Mirëpo AK-KEK ka rekomanduar për kontratë një OE tjetër për shkak të çmimit më të lirë. Për të vërtetuar këtë është raporti i vlerësimit të datës 19.10.2016 të AK-KEK. Këtu shumë qartë shkruan se ne jemi OE i përgjegjshëm pa asnjë vërejtje, ky është raporti i komisionit vlerësues. Mirëpo ne të pakënaqur me vendimin kemi kërkuar qasje në dokumentacionin e tenderit dhe kemi vërejtur se OE i rekomanduar për kontratë ka falsifikuar, manipuluar, mashtruar, me dosje të tenderit. Ne nuk jemi lajmëruar në polici pasi është detyrë e AK-së të raportoj rastin në OSHP dhe me këtë rast nuk dimë a kanë vepruar ashtu. Mirëpo AK kanë aprovuar ankesën tonë tërësisht të bazuar dhe kanë kthyer

lëndën në Rivlerësim. Pasi që nuk kanë arritur qëllimin që të shpallet fitues OE i tyre i preferuar, këta në raportin e dytë të komisionit të Rivlerësimit, na bëjnë neve të papërgjegjshëm me arsyetime duke u thirrur në dokumente që janë vetëm si shembull informativ. Ashtu siç jemi përgjigjur me datë 02.03.2017 në raportin e ekspertizës, ne nuk jemi pajtuar me mendimin e ekspertëve, sepse të njëjtit ekspert ndoshta për shkak volumit të madh të dosjes ka pas gjasa ti ikin detaje nga kërkesa e AK dhe nuk e konsiderojmë të qëllimshme nga ana tyre. Kjo për arsye se konstatimi 1 i ekspertizës bazohet në aneksin 8. Konstatimi 2 po ashtu bazohet në aneksin 8, konstatimi 3 bazohet në aneksin 8, konstatimi 4 bazohet në aneksin 9, konstatimi 5 bazohet në aneksin 10, konstatimi 6 bazohet në aneksin 11, konstatimi 7 bazohet në aneksin 12. Për këtë shumë qartë në specifika teknike të detyrueshme shkruan “prej aneksit 5 deri te aneksi 15 janë si shembull informativ”. Për më tepër poashtu në dosje në fletën e njëjtë për këtë stacion ngasës kërkohet të bëhet modifikimi, ridizajnimi, forcimi i strukturës dhe nënstrukturës. Për të plotësuar arsyeshmërinë e ankesës tonë, në aneksin 1 të specifiakt e detyrueshme 4.4.1 “kontraktuesi mund të ofroj zgjidhje tjetër të reduktorit por duhet të ketë parasysh që të mos ndryshoj shpejtësinë e konvejerit”. Parametrat bazë të kërkuara nga KEK janë, shpejtësia shiritit, gjerësia shiritit, dhe kapaciteti bartës si dhe gjatësia maksimale. Në këto në ofertë shumë qartë i kemi prezantuar dhe se nuk do ndryshojnë. Bile çka është në të mirë të KEK kapaciteti bartës i shiritit ja kemi ofruar dyfish më të madh, nga 2400 metër kub në orë, e kemi ofruar 5500 metër kub në orë. Njëherit kërkojmë që edhe ekspertët për shkak lëshimeve teknike të tërhiqen nga mendimi tyre pasi ato kanë qenë vetëm anekse informative, dhe ka mund të ju ikë, andaj kërkojmë nga paneli shqyrtues që të anulohet vendimi i AK-KEK për anulim të këtij aktiviteti dhe si palë me interes juridik material të shpallemi fitues i këtij projekti dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Kryetari i panelit shqyrtues pyeti ekspertët se a mendoni se keni shqyrtuar gjithë lëndën edhe pse nga puna ime këtu nuk kam parë lëndë më të madhe, dhe nëse jo, a ju nevojitet kohë më shumë për shqyrtimin e lëndës?

Në përgjigje eksperti shqyrtues ka deklaruar: “Pas konsultimit me ekspertin teknik, siç keni parë ka qenë lëndë shumë voluminoze. Eksperti ka bërë shqyrtim detal të lëndës, mirëpo është bërë një lëshim gjatë shqyrtimit sepse anekset që nuk kanë qenë obligativ kanë qenë si shembuj, dhe eksperti teknik është bazuar në to kur ka hartuar ekspertizën. Për këtë do ja kaloja fjalën ekspertit teknik sa i përket anës teknike, mirëpo mendoj se për anekset 5 deri 15 duhet të tërhiqen sepse të njëjtit nuk mund të merren si obligativ, pasi ashtu janë të caktuara në dosje.

Në vazhdim eksperti teknik z.Sarkocevic ka deklaruar: “Unë kam shikuar dokumentet e AK dhe OE ankues, mbi bazën e çka është dashtë të shqyrtoj lëndën. Duhet të sqaroje ajo çka ka ofruar OE ankues mund të bëhet vetëm nëse bëhet rikonstruimi i komplet strukturës. Këtu tani shoh se lejohet rikonstruimi strukturës dhe këtë nuk e kam parë më herët.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-KEK ka deklaruar: “Deklaroj nga aspekti i prokurimit, së pari vet thënia e OE në leximin e titullit riparimi mekanik, përcakton fushën e tenderit në cilën është kërkuar riparim mekanik dhe elektrik, të shiritit transportues me gjerësi 1800 mm, dhe vet thënia e OE të pika 8.2 ekzekutimi punëve në vijim dhe riparimi, projektet me qelës në dorë. Po ashtu kemi vërejtur dytë për nga aspekti i prokurimit, pasi vet ofrimi stacionit të ri në ofertën e OE ankues paraqet variante të cilën nuk kemi autorizuar në dosje të tenderit. Ne pajohemi me konstatimin e ekspertit shqyrtues dhe kemi vërejt se plotësisht ai ka kuptuar qëllimin dhe brendinë e tenderit-dosjes së tenderit. Andaj do cek se nuk janë ato pika vetëm informative,

informative janë gjitha lëndën në specifikimin teknik të detyrueshëm të dosjes. Gjitha ato anekse që ceku zotëri janë si dokumente informative për të dhëna teknike të dosjes së tenderit të përfshira në aneksin 1. Të gjithë prej 1 deri aneks 15 janë përfshirë në dosje të tenderit dhe aneksin të dhënave teknike të detyrueshme që çdo OE duhet plotësuar. Edhe eksperti është bazuar në atë dhe normal ka dhënë të njëjtat sugjerime. Kam dhënë për çdo pozicion, nëse jeni të pajtimit të shqyrtojme, OE ankues nuk i është përmbajtur dosjes – gjegjësisht specifikimit teknik të detyrueshëm. Qëndrojmë pranë konstatimit të ekspertit shqyrtues. Po ashtu nuk janë vetëm plakat makinerike mirëpo ka pas të meta dhe në aspektin elektrik.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues ka deklaruar: “Eksperti teknik sa i përket specifikave teknike ka rënë në lajthitje nga AK”.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti teknik ka deklaruar: “Bazuar në dokumentacionin , qëndron cili aneksi i referohet cilës pjesë. Si ekspert teknik për të bërë krahasimin mes asaj që ka ofruar OE dhe çka ka kërkuar AK, janë vetëm ato anekse. Në raport un kam dhënë specifikat e detyrueshme të AK-së. Dallimi ekziston dhe është shumë i madh mes pajisjeve ekzistuese dhe asaj çka ka ofruar , dhe duhet bërë rikonstruimi komplet i strukturës ekzistuese.

Në fund përfaqësuesi i OE ankues ka deklaruar: “Askush nuk konteston anekset që kanë ofruar, mirëpo shumë qartë në aneksin e specifikave teknik shkruan qartë që “ nga aneksi 1 deri në 15 janë vetëm për informacion”. Shumë qartë shkruan po ashtu se “OE mund të ofroj zgjidhje tjetër , por të mos ndryshoj shpejtësinë e shiritit”, dhe është e palogjikshme të ofrohen produkte të viteve 1990-ta. I propozojmë panelit të anulohet vendimi i AK-së dhe të kthehet lënda në Rivlerësim.

Në fund përfaqësuesi i AK ka deklaruar: “OE ankues ka vërejtje po ashtu sa i përket elektrikes. Sipas dosjes janë kërkuar dokumente obligative dhe për pozicionin 2 kabina manipuluese ku njeriu do punoj tri ndërrime nga 8 orë, është kërkuar katalog, me specifika teknike për termoizolim, llamarinë etj, dhe nuk është ofruar katalog nga OE ankues dhe komisioni nuk ka pas si të bëjë krahasim i specifikave. Janë kërkesat si B1 për kundër zjarrit etj. Gjatë kronologjisë OE përqendrohet në pika favorizuese për të, mirëpo nuk cek raportin e vlerësimit me ekspert të KEK të lamisë përkatëse, dhe në bazë të kërkesave tona për zgjidhje teknike për sistemet ekzistuese, ne nuk kemi kërkuar rrënim dhe të vendoset sistem i ri, mirëpo riparim të sistemit. OE ndërlihet në informata të anekseve dhe thotë vetëm për informim, mirëpo gjitha informatat e dhëna janë për informim.

Paneli shqyrtues, pas analizimit të të gjitha shkresave të lëndës fakteve dhe provave të prezantuara, prezantimeve në seancën për shqyrtim kryesor, ka konstatuar, se autoriteti kontraktues tek specifikimet teknike të detyrueshme ka kërkuar që “në stacionin veprues-ngasës i cili riparohet është e domosdoshme të bëhet modifikimi, ridizajnimi dhe riformimi i nevojshëm i strukturës nënstrukturën e çelikut në platon mbajtëse për kontejnerët e ri elektrik që vendosen në stacionin veprues”, ndërsa OE ankues ka ofruar stacion të ri veprues në kundërshtim me kërkesën e AK-së, e që nënkupton se ky OE ka ofruar më variante, kurse variantet nuk janë autorizuar në dosje të tenderit. Prandaj ky OE ankues është i papërgjegjshëm.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se prej aneksit 5 deri te aneksi 15 janë shembuj informativ, paneli shqyrtues sqaron dhe konstaton se tek specifikimet teknike të detyrueshme shkruan “*prej aneksit 5 deri te aneksi 15, janë si shembuj informativ duke u bazuar në konvejerin D2.2 ku mund të merren dimensionet si informatë por punët duhet të bëhen sipas specifikimit të detyrueshëm*” prandaj shihet qartë që të gjitha specifikimet teknike që janë parashikuar tek specifikimet teknike të detyrueshme janë të detyrueshme për operatorët ekonomik dhe është dashur ti përmbahen të gjithë ofertuesit. Prandaj pretendimi i OE ankues është i paqëndrueshëm.

Paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve e ka bërë konform nenit 59 dhe 56 të LPP-së dhe konform specifikimeve teknike të detyrueshme siç janë parashikuar në dosje të tenderit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – “Korporata Energjetike e Kosovës”

1x1 OE – FAM (Förderanlagen Magdeburg) - Gjermani & N.T.SH EKOINVEST” - Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së

1x1 Për publikim në ëeb- faqe të OSHP-së.